FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

Raporti i aktivitetit "GJIMNASTRADA E KOSOVËS 2025"

Data: 15 Mars 2025
Vendi: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, Prishtinë
Organizator: Federata e Gjimnastikës e Kosovës
Mbështetës: MKRS dhe Kompania Liri (Prizren)

Përshkrimi i aktivitetit

Federata e Gjimnastikës e Kosovës, bazuar në kalendarin vjetor të saj të aktiviteteve, organizoi më 15 Mars 2025 Gjimnastradën. Qëllimi i këtij aktiviteti është masivizimi i sportit të gjimnastikës përmes performancave të lirshme të Klubeve sipas rregullave të gjimnastradës. Aktiviteti u zhvillua në ambientet e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sporteve në Prishtinë, ku morën pjesë gjithsej 186 pjesëmarrës.

Klubet pjesëmarrëse

Në aktivitet morën pjesë gjimnaste nga këto klube: Akademia e Gjimnastikës Ardhmëria, Klubi i Gjimnastikës Omnisport**,** Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosova**,** Klubi i Gjimnastikës Skenderaj**,** Klubi i Gjimnastikës Elita**,** Klubi i Gjimnastikës Xheni Gjimnastikë (Shqipëri) dhe një përformance individuale nga gjimnastja Fiona Konxheli.

Ecuria e aktivitetit

Aktiviteti filloi në orën 10:00 me një fjalë hyrëse nga Kryetari i FGJK-së Shkumbin Maqastena . Salla ishte e mbushur me publik, dhe numri i gjimnasteve ishte shumë i madh. Të gjithë pjesëmarrësit morën dhurata simbolike, falë bashkëpunimit me kompaninë Liri Prizren.
Pas të gjitha përformancave, aktiviteti përfundoj në ora 12:30.

Përfundim

Gjimnastrada 2025 përmbushi plotësisht misionin e saj si një ngjarje promovuese dhe njëherit argëtuese për gjimnastët, trajnerët dhe publikun. Ky aktivitet ishte një dëshmi për rëndësin që FGJK i kushton përfshirjes dhe masivizimit të gjimnastikës në vend.

Foto nga Gjimnastrada 2025:








Amir Tahiraga_____

Sekretar i Përgithshëm i FGJK-së

FGJK – KGF

Shtëpia e Sporteve, Rr: "Agim Ramadani" 10000 Prishtine, tel: +38344145009, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com